



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Gllogoc
Opština Glogovac / Municipality of Gllogoc



Zyra e Kryetarit/Kancelarija Gradonaçelnika/Mayor's Office
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/ Jedinica za/Single Resource Manager

Duke u bazuar në nenet 9, 77, 78, 79, 80, 81 dhe 82 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Neni 6, 7, 8, 10 dhe 11 i Rregullores (QRK) - nr. 30/2024 Për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë si dhe Kërkesave Nr.216 të dt.25/02/2026 dhe Nr.260/06.03.2026 së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe pas aprovimit të tyre, Komuna e Drenasit shpall:

KONKURS

(I jashtëm, për plotësimin e vendeve të lira të punës)

Numri i referencës: RN00019400

Titulli i vendit të punës: Mjekë të Përgjithshëm, Infermier dhe Mami në Kujdesin Parësor Shëndetësor në QKMF Dr. 'Hafir Shala' Drenas

Institucioni: Komuna e Drenasit/Gllogocit- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF Dr. "Hafir Shala" Drenas.

Lloji i pozitës: Mjekë të Përgjithshëm, Infermier dhe Mami

Numri i Pozitave: 16 (Gjashtëmbëdhjetë)

- 1 (Një) *Doktor i Mjekësisë në KPSH-Shëndeti Paliativ*
- 1 (Një) *Doktor i Mjekësisë në KPSH*
- 1 (Një) *Doktor i Mjekësisë në KPSH-AMF -Abri e Epërme*
- 1 (Një) *Doktor i Mjekësisë në KPSH- Urgjencë*
- 2 (Dy) *Mami në Shërbimin e Maternitetit të QKMF-së- Drenas*
- 10 (Dhjetë) Infermier/e në KPSH, *1 (Një) në AMF Nekoc, 1 (Një) në AMF Sankoc, 1 (Një) në MF- Drenas, 2 (Dy) në MF në Tërstenik, 1 (Një) në AMF Abri, 1 (Një) në Shërbimin Emergjent Drenas (me patentshofer), 1 (Një) në Shërbimin Emergjent Komoran (me patent shofer) dhe 2 (Dy) në Shërbimin Emergjent - Mjekësi Familjare (me patent shofer).*

Titulli i mbikëqyrësit: Shefi i Njesisë, Kryeshefi i Departamentit të Mjekësisë Familjare; Kryeinfermiere/i dhe Shefi i Dep.të Maternitetit.

Koficienti/paga: H10_8.4, H17_6.4 dhe H20_6.1 (1 koeficient është rritur me Vendim të Qeverisë, koeficientët sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik është 8.4, 6.4 dhe 6.1).

Njoftimi: 10.03.2026

Afati i aplikimit: 11.03.2026 deri 09.04.2026

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar nga pika 1-3 e këtij konkursi

Ndërsa

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar pika 4 e këtij konkursi për Infermier në Shërbimin Emergjent, mundësi vazhdimi në kontratë të përhershme nëse të njëjtit kandidatë arrijnë që brenda periudhës dy vjeçare të pajisen me certifikatë për drejtim të autoambulancës në Qendrën e Trajnimeve të Integruara në Studime të Vushtrrisë (Ligji Nr. 05/L - 024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent)

Periudha provuese: 6 muaj

Orë pune në javë: 40

1. Detyrat dhe Përgjegjësit për Doktor i Mjekësisë:

Qëllimi i përshkrimit të pozitës është përcaktimi i kompetencave të Mjekut të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuara në dëshmi përmes bashkëpunimit dhe monitorimit të ngushtë nga ana e Mjekut Familjar.

Mjek i përgjithshëm ka për detyrë të promovojë dhe përparojë shëndetin e individit , pacientit dhe familjes, duke pasur parasysh aspektin demografik dhe ambiental. Ofron kujdes gjithëpërfshirës dhe përkrahje psikosociale-fizike, për të gjithë pa dallim kulture, besimi, race, ngjyre, gjinie apo moshe, statusi social, apo vlera të përceptuara ekonomike.

Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme:

- Ofon shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësi e bazuar në dëshmi ;
- Ofon shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha episodet e jetës nën mbikqyrje të Mjekut Familjar;
- Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikqyrje të Mjekut Familjar;
- Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë;
- Përcjellja sistematike e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoloshentëve ;
- Kujdesi për personat e moshuar dhe në nevojë;
- Ofon kujdes për rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate;
- Interpreton rezultatet e testeve të shpejta laboratorike;
- Komunikon ose konsultohet me specialist të mjekësisë familjare sipas nevojës;
- Referon pacientin te specialisti i mjekësisë familjare dhe për kujdes spitalor;
- Kujdesi i vazhdueshëm për pacientet me sëmundje kronike jo ngjitëse;
- Kontrolli i sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike);
- Promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete(grupet vulnerable, vendet rurale, shkolla, komunitetet);
- Zbatimi i programit të vaksinimit;
- Edukimi shëndetësor etj.

KUJDESI NË RASTET E URGJENCËS:

Qëllimi i shërbimit. Të ofrojë në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur ndihmën për të gjitha rastet e urgjencës mjekësore, që kërcënojnë humbjen e jetës apo përkeqësojnë kushtet fizike dhe psikologjike të personit, si dhe të trajtojë dhimbjen apo sëmundshmërinë sipas rastit (kushteve të personit).

Trajtimi i urgjencave të zakonshme

Urgjencë në raste traumash:

- Stabilizimi akut i traumave (ndihma e parë dhe imobilizimi), duke përfshirë referimin dhe transportin;
- Stabilizimi akut i frakturave (ndihma e parë dhe imobilizimi), duke përfshirë referimin dhe transportin;
- Ringjallja zemër-mushkëri në rast traumash në foshnja, fëmijë dhe të rritur.

Urgjencë në raste aksidentesh të tjera (duke përfshirë referimin dhe transportin):

- Trajtim i plagëve nga djegie dhe plagë të vogla (përfshirë mbylljen elacacioneve të thjeshta);
- Ndhimja e parë në pickime nga insektet dhe kafshimet; ndihma e parë në goditjen nga dielli dhe i ftohti; ndihma e parë në asfiksi nga mbytja, trupat e huaj, gazrat; ndihma e parë në helmimet e ndryshme (ushqime ose lëndë kimike etoksike, barna, droga).

Urgjencë mjekësore jotraumatike (duke përfshirë referimin dhe transportin):

- Trajtimi i temperaturës dhe konvulsioneve febrile ose jo-febrile; qetësimi i dhimbjes anginoz, menaxhimi i krizës hipertensive, ndihma e parë në edemëpulmonare; stabilizimi i çrregullimeve të ritmit kardiak, ndihma e parë në preeklampsi dhe eklampsi, hemorragji gjatë shtatzanisë, shtatzani ekstrauterine, dhimbje abdominale akute gjatë shtatzanisë, ndihma e parë në urgjenca psikiatrike, menaxhim i diarresë akute, kolikës renale ose biliare dhe i hemorragjive të jashtme.
- Ringjallja zemër – mushkëri në urgjencat kërcënuese me natyrë jotraumatike, tek foshnjat, fëmijët dhe të rriturit.

Detyrat e ekipit:

- Inkurajohet nga puna ekipore (mjeku familjar, infermieret familjare, infermieret në komunitet);
- Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe kërkon nga anëtarët e ekipit zgjidhjen e tyre;
- Përcaktohet nga mjeku familjar si pjesë e ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e pacientit, aftësitë dhe kualifikimet, për të përmbushur nevojat e institucionit;
- Merr pjesë në trajnime, vlerësim të kompetencave, orientim dhe edukim;
- Komunikon qartë, saktë dhe krijon klimë të mirë për punë që rritë kënaqshmëritë në punë;

Detyrat administrative:

- Vepron në mënyrë profesionale, duke respektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSh në fuqi;
- Përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë;
- I nënshtrohet programit nacional të zhvillimit të vazhdueshëm profesional;
- Përkujdeset për konfidencialitetin e individit;
- Përcjell sëmundshmërinë nën mbikëqyrje të mjekut familjar;

- Identifikon grupet e veçanta të rrezikut;
- Merr pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjial dhe sjellë vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve;
- Ndihmon mjekun familjar në zhvillimin e auditeve mjekësore në institucionin përkatës;
- Merr pjesë në takime, konferenca dhe tregon interesim në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit;

Standardet e performansës:

- Demonstron shkathtësi optimale klinike profesionale;
- Tregon aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP;
- Tregon përkushtim për ngritjen profesionale dhe përmirësim të kompetencave;
- Respekton konfidencialitetin 100% të kohës;
- Shkruan qartë dhe lexueshëm.

Kushtet dhe kriteret për Mjek të Përgjithshëm :

- Të ketë të kryer Fakultetin e Mjekësisë;
- Licenca e punës lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë- OMK ;
- Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të këtë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip, si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulturë, etnike, religjioni apo race.

2. Detyrat e Mamisë në Njësinë e Maternitetit

- Zbaton dhe dokumenton kujdesin pacientëve me kushte të ndryshme të sëmundjes sipas standardeve të punës;
- Monitoron dhe transporton pacientët me vështirësi në levizje për ekzaminime të ndryshme brenda institucionit;
- Kujdeset për sigurinë e pacientit dhe monitorimin e vazhdueshëm të tij;
- Realizon aktivitete për punën ekipore;
- Bashkëpunon me profile tjera profesionale në menaxhimin e pacientëve;
- Rregullon, pastron dhe mirëmban hapsirën e punës, rrethinën e pacientit, paisjet, instrumentet dhe mjetet e punës;
- Aplikon procedurat standarde të sterilizimit të instrumenteve të punës dhe dezinfektimit;
- Trajton me kujdes racional dhe të saktë materialin, paisjet, mjetet e punës dhe paisjet mjekësore;
- Përgatitë materialet dhe mjetet e punës për përdorim dhe intervenim;
- Kryen detyrat tjera të punës sipas rendit të punës ose punët e mbetura nga ekipi i ndërrimit paraprak ose punë tjera të kërkuara prej kryeinfermierës ose shefit të repartit;
- Cakton, planifikon, implementon dhe vlerëson kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me praktikat klinike të aprovuara;
- Mbledh dhe proceson të dhëna të sakta për pacientin;
- Siguron komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët e përkujdesur gjatë orarit të punës;
- Ndanë informata të sakta për pacientët lidhur me kujdesin që ju ofrohet;

- Administron terapinë e përshkruar në përputhje me praktikat klinike institucionale;
 - Merr pjesë në aktivitetet e organizuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informatave në mes personelit shëndetësor;
 - Ruan konfidencialitet të plotë për çështje që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në raste kur kjo autorizohet me shkrim, në përputhje me rregullat institucionale;
 - Merr pjesë në aktivitetet e ZHVP-së në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës infermierike;
 - Siguron kujdes për nënat dhe foshnjat gjatë lindjes duke informuar mjekun për problemet eventuale;
 - Pranon dhe vlerëson gratë që vijnë për lindje ose me probleme gjatë shtatzënisë;
 - Bën kontrollin fillestar obstetrik (matja e tensionit, temperatura, CTG – kardiotokografia, etj.);
 - Informon mjekun obstetër në rastet e ndërlikuara;
 - Pranon dhe vlerëson gratë që vijnë për lindje ose me probleme gjatë shtatzënisë;
 - Bën kontrollin fillestar obstetrik (matja e tensionit, temperatura, CTG – kardiotokografia, etj.);
 - Mbikëqyr fazat e lindjes dhe siguron përparimin normal të saj;
 - Jep ndihmën profesionale për lindjet vaginale pa komplikime;
 - Përgatit materialet e nevojshme për lindje dhe intervenime të mundshme;
 - Siguron një ambient të sigurt dhe mbështetës për nënën gjatë lindjes;
 - Kryen kujdesin e menjëhershëm për nënën dhe foshnjën (matja e APGAR-it, kontrolli i gjakderdhjes, kontraktimet e mitrës, etj.);
 - Ndiemon me vendosjen e kontaktit të parë nënë-foshnje dhe ushqyerjen me gji;
 - Monitoron parametrat jetësorë të nënës dhe foshnjës;
 - Bën edukimin e nënës për kujdesin ndaj vetes dhe foshnjës në ditët e para;
 - Plotëson dokumentacionin mjekësor për lindjen, për nënën dhe foshnjën;
 - Siguron pastërtinë dhe dezinfektimin e dhomave të lindjes dhe paisjeve;
 - Kontrollon dhe përgatit materialet sterile;
 - Kujdeset për ruajtjen dhe përdorimin e sigurt të barnave dhe pajisjeve;
 - Në kuadër të Dhomës për Promovim dhe Edukim Shëndetësor, kryen edhe detyrat e Programit të Kujdesit Grupor për Prindërim;
 - Kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Kryeinfermieres/it dhe Shefit të Dep.të Maternitetit.
- **KUALIFIKIMI**
1. Të ketë të kryer Bachelor Mami/Shkollë e mesme Mami
 2. Të jetë mami i/e regjistruar dhe licencuar në OIK;
 3. Të ketë aktivitetet dhe trajnime të realizuara dhe të dëshmuara në/nga OIK,
 4. Të ketë ndjenja përgjegjësie i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve;
 5. Të ketë shkathtësi të mira të komunikimit;
 6. Të ketë shkathtësi pune i/e pavarur dhe në ekip;
 7. Të ketë njohuri të punës me kompjuter dhe të gjuhëve të huaja;
 8. Të ketë gatishmëri të punoj me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etniciteti, religjioni apo race.

3. Infermier/e në KPSH

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

Qëllimi i përshkrimit të pozitës është përcaktimi i kompetencave për ofrimin dhe udhëheqjen e kujdesit infermierik dhe bashkëpunimit të ngushtë me anëtarët e ekipit të mjeksisë familjare. Infermieri/ja familjar/e (IF në KPSH ka për detyrë të promovojë dhe përpunojnë shëndetin e individit pacientit dhe familjes përmes ofrimit, delegimit, vlerësimit dhe bashkëpunimit gjithpërfshirës profesional të kujdesit sipas procesit infermieror, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni dhe race, duke ofruar perkrasje psikosociale dhe fizike për individin, pacientin dhe familjen. Infermieri/ja familjar/e është anëtar i ekipit të Mjeksisë Familjare, punon i-e pavarur dhe me ekipe multi-profesionale dhe sugjeron detyrat e riorganizuar në praktikë me qëllim të përmirësimit të performancës së institucionit në tërësi.

3.1. KUJDESI NDAJ PACIENTIT

- 1.1 Praktikon në përputhje me kodin etik dhe zbaton procesin e kujdesit infermier të dokumentuar;
- 1.2. Reagon në mënyrë efektive për të papriturat ose ndryshon situatën me shpejtësi;
- 1.3. Vlerëson, planifikon, zbaton dhe rivlerëson kujdesin infermieror të ofruar në përputhje me moshën, gjendjen fizike, psikosociale, kulturore dhe shpirtërore të individit, pacientit dhe familjes, në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara;
- 1.4. Menaxhon rastet dhe avokon për të drejtat e tyre, duke qenë burim dhe person kontaktues për ta;
- 1.5. Komunikon në mënyrë efektive me individin pacientin apo familjen dhe ofron kujdes të standardit të lartë dhe dokumenton punën e bërë;
- 1.6. Ofron promovim dhe edukim shëndetësor për individin pacientin dhe familjen me theks të veçantë në marrjen e përgjegjësisë për vetëkujdes konform moshës dhe nevojave të identifikuara;
- 1.7. Grumbullon dhe dokumenton të dhënat subjektive dhe objektive për individin pacientin dhe rishqyrton informatat themelore të individit pacientit duke u përqendruar në ambientin ku jeton, vetëkujdesin dhe planifikimin e metutjeshëm;
- 1.8. Ofron shërbime për të parandaluar sëmundjen dhe për të avancuar dhe promovuar jetë të shëndoshë dhe të sigurtë lidhur me shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar;
- 1.9. Ofron shërbimet e kujdesit Ante, Peri dhe post natal, imunizimin dhe vaksinimin, zhvillimin e fëmijëve, kujdesin për adoleshentë dhe të rinjë dhe shëndetin oral prevenues;
- 1.10. Ofron shërbime infermierore duke përfshirë kujdesin shtepiak për nëna dhe fëmijë me sëmundje kronike jo ngjitëse, shëndet mendor dhe kujdesin terminal paliativ;
- 1.11. Përgatit dhomen e egzaminimit me paisje dhe furnizime të nevojshme të kërkuara për vizitë, njëherit asiston gjatë ekzaminimit dhe procedurave të kërkuara.
- 1.12. Administron terrapin enterale dhe paraenterale, të përshkruara nga mjeku familjar, me shkathtësi dhe përpikmëri;
- 1.13. Respekton masat aseptike gjatë marrjes së mostrave laboratorike përfshirë edhe kontrollën e kualitetit dhe mirëmbajtjen e të gjitha testeve të shpejta laboratorike diagnostike dhe informon menjëherë rezultatet me vlera jonormale të testeve laboratorike të ordinuara nganjëherë familjar;
- 1.14. Përmban konfidencialitet të plotë për të gjitha qeshtjet që i përkasin individit pacientit dhe familjes, veprimtarisë së KPSH, përveq nëse është i-e autorizuar me shkrim nga menaxheri;

1.15. Mbështet dhe kontribuon në hulumtime të kujdesit shëndetësor , që ndërlidhen me dëshmit për siguri dhe praktikën efektive që ndërlidhet me të gjitha vendet e punës infermiore duke përfshirë edhe vendet e punës e detyrat specifike si në intervencë, triazhim, kartotekë, recepcion, urgjencë-emergjencë, transport shëndetësorë , me komunitet, vaksinim-imunizim, SISH, shendet oral, radiologji, Lab. etj.).

3.2. DETYRAT E EKITIT

1. Inkurajohet nga puna ekipore (mjeku familjar, mjekun e përgjithshëm, stomatologun, infermierët familjar, infermierët në komunitet dhe asistentin e stomatologut;
2. Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe ndihmon për zgjidhjen e tyre;
- 3 Vepron në cilësinë e anëtarit të ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e institucionit për kujdesin sa më cilësor për individin pacientin dhe familjen;
4. Merr pjesë në takime konsultative, profesionale, komunikojnë qartë saktë dhe krijojnë klimë të mirë pune që të rritë kënaqësit e individit pacientit dhe familjes;
5. Është burim i njohurive dhe shkathtësive për anëtarë tjerë të ekipit për të shkëmbyer përvojat klinike.

3.3. DETYRAT ADMINISTRATIVE

1. Vepron në mënyrë profesionale dhe në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi për KPSH;
2. Zbaton detyrat e deleguara nga menaxheri në pajtueshmëri me politikat shëndetësore në fuqi, gjithnjë duke ruajtur konfidencialitetin profesional;
3. Punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor në KPSH, duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezultatit të kujdesit ndaj individit pacientit dhe familjes;
4. Identifikon rëndësinë e kërkimit për të përmirësuar rezultatet e shëndetit për individin pacientin;
5. Realizon veprimin e duhur dhe të sigurtë, deponon dhe administron paisjet, harnat dhe të gjitha informatat klinike në mënyrë të duhur dhe me kosto efektive;
6. Merr pjesë në zhvillimin dhe përpilimin e udhëzimeve dhe protokoleve të shkruara, procedurave për shërbime infermiore;
7. Zbaton protokolet e praktikave infermiore të bazuara në dëshmi, mbledhje të dhënave në mënyrë sistematike dhe vlerëson të dhënat në aspektin fizik, socio-kulturor dhe mendon për shëndetin e individit pacientit dhe familjes;
8. Merr pjesë në mbledhjet dhe aktivitetet e ekipit të mjekësisë familjare për të përmirësuar performancën e tijp-saj dhe të institucionit
9. Ka qëndrim pozitiv drejt ndryshimeve në përmirësimin e kujdesit dhe ngritjen e cilësisë.

3.4. STANDARDET E PERFORMANCËS

1. Demonstron shkathtësi klinike të larta profesionale;
2. Tregon aftësi për zbatimin e detyrave të punës sipas PVP;
3. Demonstron dhe mbështet standardet e persosëmërisë së shërbimeve sipas PVP;
4. Tregon përkushtim për ngritje profesionale dhe përmirësim të kompetencave;
5. Respekton plotësisht konfidencialitetin;
6. Shkrimi duhet jetë i qartë dhe i lexueshëm.

3.5. KUALIFIKIMI

1. Të ketë të kryer drejtimin: Shkolla e mesme e mjekësisë/ Bachelor (mjekësi e përgjithëshme/pediatri);,
2. Të jetë infermier/e/pediatri i/e regjistruar dhe licencuar në OIK;
3. Të ketë aktivitete dhe trajnime të realizuara dhe të dëshmuara në/nga OIK,
4. Të ketë ndjenja përgjegjësie i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve;
5. Të ketë shkathtësi të mira të komunikimit;
6. Të ketë shkathtësi pune i/e pavarur dhe në ekip;
7. Të ketë njohuri të punës me kompjuter dhe të gjuhëve të huaja;
8. Të ketë gatishmëri të punoj me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etniciteti, religjioni apo race.

4. Kohëzgjatja e emërimit, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Infermierit/es Familjarë në Urgjencë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar për periudhë (2) dy vjeqare, me mundësi vazhdimi në kontratë të përhershme nëse të njëjtit kandidatë arrijnë që brenda periudhës dy vjeqare të pajisen me certifikatë për drejtim të autoambulancës në Qendrën e Trajnimeve të Integruara në Studime të Vushtrrisë (Ligji Nr. 05/L - 024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent)

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

Qëllimi i përshkrimit të pozitës është përcaktimi i kompetencave për ofrimin dhe udhëheqjen e kujdesit infermierik dhe bashkëpunimit të ngushtë me anëtarët e ekipit të mjekësisë familjare. Infermierija familjare (IF në KPSH ka për detyrë të promovojë dhe përpunojnë shëndetin e individit pacientit dhe familjes përmes ofrimit, delegimit, vlerësimit dhe bashkëpunimit gjithpërfshirës profesional të kujdesit sipas procesit infermieror , pa dallim moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni dhe race, duke ofruar perkrasje psikosociale dhe fizike për individin, pacientin dhe familjen. Infermieri-ja familjare është anëtar i ekipit të Mjekësisë Familjare, punon i-e pavarur dhe me ekipe multi-profesionale dhe sugjeron detyrat e riorganizuara në praktikë me qëllim të përmirësimit të performancës së institucionit në tërësi.

5. KUJDESI NDAJ PACIENTIT

- Praktikon në përputhje me kodin etik dhe zbaton procesin e kujdesit infermier të dokumentuar;
- Reagon në mënyrë efektive për të papriturat ose ndryshon situatën me shpejtësi;
- Vlerëson, planifikon, zbaton dhe rivlerëson kujdesin infermieror të ofruar në përputhje me moshën, gjendjen fizike, psikosociale, kulturore dhe shpirtërore të individit pacientit dhe familjes, në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara;
- Menaxhon rastet dhe avokon për të drejtat e tyre, duke qenë burim dhe person kontaktues për ta;
- Komunikon në mënyrë efektive me individin pacientin apo familjen dhe ofron kujdes të standardit të lartë dhe dokumenton punën e bërë;
- Ofron promovim dhe edukim shëndetësor për individin pacientin dhe familjen me theks të veçantë në marrjen e përgjegjësisë për vetëkujdes conform moshës dhe nevojave të identifikuar;

- Grumbullon dhe dokumenton të dhënat subjective dhe objective për individin pacientin dhe rishqyrton informatat themelore të individit pacientit duke u përqendruar në ambientin ku jeton, vetëkujdesin dhe planifikimin e metutjeshëm;
- Ofron shërbime për të parandaluar sëmundjen dhe për të avancuar dhe promovuar jetë të shëndoshë dhe të sigurtë lidhur me shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar;
- Ofron shërbimet e kujdesit Ante, Peri dhe post natal, imunizimin dhe vaksinimin, zhvillimin e fëmijëve, kujdesin për adoleshentë dhe të rinjë dhe shëndetin oral prevenues;
- Ofron shërbime infermiere duke përfshirë kujdesin shtëpiak për nëna dhe fëmijë me sëmundje kronike jo ngjitëse, shëndet mendor dhe kujdesin terminal paliativ;
- Përgatit dhomen e egzaminimit me paisje dhe furnizime të nevojshme të kërkuara për vizitë, njëherit asiston gjatë ekzaminimit dhe procedurave të kërkuara.
- Administron terrapin enterale dhe paraenterale, të përshkruara nga mjeku familjar, me shkathtësi dhe përpikmëri;
- Respekton masat aseptike gjatë marrjes së mostrave laboratorike përfshirë edhe kontrollën e kualitetit dhe mirëmbajtjen e të gjitha testeve të shpejta laboratorike diagnostike dhe informon menjëherë rezultatet me vlera jonormale të testeve laboratorike të ordinuara nga mjeku familjar;
- Përmban konfidencialitet të plotë për të gjitha qeshtjet që i përkasin individit pacientit dhe familjes, veprimtarisë së KPSH, përveq nëse është i-e autorizuar me shkrim nga menaxheri;
- Mbështet dhe kontribuon në hulumtime të kujdesit shëndetësor , që ndërlidhen me dëshmit për siguri dhe praktikën efektive që ndërlidhet me të gjitha vendet e punës infermiere duke përfshirë edhe vendet e punës e detyrat specifike si në intervencë, triazhim, kartotekë, recepcion, urgjencë-emergjencë, transport shëndetësorë , me komunitet, vaksinim-imunizim, SISH, shendet oral, radiologji, Lab. etj.).

6. DETYRAT E EKITIT

- Inkurajohet nga puna ekipore (mjeku familjar, mjekun e përgjithshëm, stomatologun, infermierët familjar, infermierët në komunitetet dhe asistentin e stomatologut;
- Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi I mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe ndihmon për zgjidhjen e tyre;
- Vepron në cilësinë e anëtarit të ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e institucionit për kujdesin sa më cilësor për individin pacientin dhe familjen;
- Merr pjesë në takime consultative, profesionale, komunikojnë qartë saktë dhe krijojnë klimë të mirë pune që të rritë knaqësit e individit pacientit dhe familjes;
- Është burim i njohurive dhe shkathtësive për anëtarë tjerë të ekipit për të shkëmbyer përvojat klinike.

7. DETYRAT ADMINISTRATIVE:

- Vepron në mënyrë profesionale dhe në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi për KPSH;

- Zbaton detyrat e deleguara nga menaxheri në pajtushmëri me politikat shëndetësore janë fuqi, gjithnjë duke ruajtur konfidencialitetin profesional;
- Punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor në KPSH, duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezultatit të kujdesit ndaj individit pacientit dhe familjes;
- Identifikon rëndësinë e kërimit për të përmirësuar rezultatet e shëndetit për individin pacientin;
- Realizon veprimin e duhur dhe të sigurtë, deponon dhe administron paisjet, harnat dhe të gjitha informatat klinike në mënyrë të duhur dhe me kosto efektive;
- Merr pjesë në zhvillimin dhe përpilimin e udhëzimeve dhe protokoleve të shkruara, procedurave për shërbime infermiere;
- Zbaton protokolet e praktikave infermiere të bazuara në dëshmi, mbledhje të dhënave në mënyrë sistematike dhe vlerëson të dhënat në aspektin fizik, socio-kulturor dhe mendon për shëndetin e individit pacientit dhe familjes;
- Merr pjesë në mbledhjet dhe aktivitetet e ekipit të mjekësisë familjare për të përmirësuar performancën e tij-saj dhe të institucionit
- Ka qëndrim pozitiv drejt ndryshimeve në përmirësimin e kujdesit dhe ngritjen e cilësisë përmes IVM;

8. STANDARDET E PERFORMANCËS

- Demonstron shkathtësi klinike të larta profesionale;
- Tregon aftësi për zbatimin e detyrave të punës sipas PVP;
- Demonstron dhe mbështet standardet e persosëmërisë së shërbimeve sipas PVP;
- Tregon përkushtim për ngritje profesionale dhe përmirësim të kompetencave;
- Respekton plotësisht konfidencialitetin;
- Shkrimi duhet jetë i qartë dhe i lexueshëm.

9. DETYRAT SPECIFIKE për infermier/e në sektorin e urgjencës (Recepcion, Intervencë, Observim, transport dhe shofer në autoambulancë)

➤ NË RECEPCION

Detyrat dhe përgjegjësitë: të gjitha punët, detyrat e punës dhe përgjegjësitë e infermierike, duke pasqyruar edhe përgjegjësitë specifike të vendeve të punës brenda sektorit si:

- Është përgjegjës për triazhimin e pacientëve urgjent;
- Kryen regjistrimin dhe protokollimin e pacientëve;
- Kryen pagesën e participimit sipas llojeve të shërbimeve përkatëse në bazë të dëftesës së dhënë dhe të evidentuar;
- Kujdeset që secilit pacient t'i ipet fletëpagesa për pagesën e kryer të shërbimit të ofruar;
- Përgjigjet në thirrje telefonike;
- Përgatit ordinancën e mjekut;
- Kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Kryeinfermierit të Urgjencës.
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit të Urgjencës;

➤ NË INTERVENCË

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Aplikon terapinë të rastet urgjente, sipas urdhëresës së mjekut;
- Kryen fashimet dhe asiston te inetrvenimet e vogla;
- Sterilizon mjetet dhe materialin për fashime dhe intervenime të vogla;
- Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;
- Mban evidencën për terapinë e aplikuar sipas reçetave të përshkruara;
- Në vazhdimësi kujdeset për sigurimin dhe plotësimin e antishok terapisë;
- Kontrollon afatin e skadencës së antishok terapisë;
- Sipas nevojës dhe urdhërave të përgjegjësit kryen edhe punët tjera të infermierit në Urgjencë;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit të Urgjencës;

➤ NË DHOMËN E OBSERVIMIT

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën stabilizimin e gjendjes së pacientëve urgjent;
- Bën përcjelljen e gjendjes dhe terapisë së pacientëve të vendosur në dhomën e observimit;
- Kontrollon funksionimin e aparaturës në dhomën e observimit;
- Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;
- Ndjekë trajnimet e vazhdueshme në ngritjen e shkathtësive në menaxhimin e rasteve urgjente;
- Bën përgatitjet sa më profesionale të pacientëve urgjent në raste të përcjelljes së tyre në Qendra më të avansuara;
- Sipas nevojës dhe urdhërit të përgjegjësit kryen edhe punët tjera të Infermierit në Urgjencë;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit të Urgjencës.

➤ NË PËRCJELLJE TË RASTEVE GJATË TRANSPORTIT

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për transportimin e pacientëve nga shtëpia deri në Urgjencë si dhe deri në qendrat tjera më të avansuara;
- Bën aplikimin e terapisë si dhe përcjelljen e shenjave vitale gjatë kohës së transportit të pacientve;
- Bën bartjen e pacientëve prej shërbimit deri në autoambulancë dhe anasjelltas;
- Sipas nevojës dhe urdhërave të përgjegjësit të shërbimin të urgjencës, kryen edhe punët tjera të Infermierit në Urgjencë;
- Ndjekë trajnimet e vazhdueshme në ngritjen e shkathtësive në menaxhimin e rasteve urgjente;
- Raporton përgjegjësin e parkut të automjeteve për gjendjen e autoambulancaës dhe paisjeve mbrenda sajë.

➤ **Infermier-shofer NË TRANSPORTIN E RASTEVE ME AUTOAMBULLANCË**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën transportimin e rasteve urgjente të pacientve në bazë të urdhëresës së personit të autorizuar (24) orë (Doktorit të sektorit urgjences ose shefit të sektorit);
- Mban evidencën në formularë të relacionit dhe kilometrat e kaluara
- Kryen punët ekipore në bartjen e pacientëve gjatë transportit;
- Aplikon aftësit profesionale së bashku me ekipin në vendin e ngjarjes
- Kujdeset për higjienën e autoambulancës pas rasteve të transportuara së bashku me ekipin.
- Mbikqyrë gjendjen aparaturës përcjellëse mjekësore në autoambulancë;
- Raporton të përgjegjësi i shërbimit për gjendjen e aparaturave në autoambulancë
- Raporton përgjegjësin e parkut të automjeteve për gjendjen e autoambulancës;
- Zbaton procedurat standarde në komunikacion gjatë drejtimit të autoambulancës
- Për punën e vetë i përgjigjet Kryeinfermierit të Urgjencës dhe bashkëpunon me përgjegjësin e parkut të makinave.
- Për gjendjen e Autoambulancës i përgjigjet personit përgjegjës të parkut të makinave.
- Zbaton procedurat e pranimit dorëzimit të ndrrimit të ekipa pasuese për gjendjen e autoambulancës dhe paisjeve mjekësore
- Kryen edhe trajnime shtesë nga infermiera ose ngasja e autoambulancave dhe mjeteve tjera motorrike të KPSH.
- Zbaton procedurat standarde të mirëmbajtjes dhe përdorimit të automjeteve zyrtare dhe autoambulancave në bazë të Rregullores të aprovuar nga institucioni.

Kushtet dhe kriteret për Infermierë në Urgjencë:

- Diploma nga lëmia infermierisë - bachelor, shkolla e mesme e mjekësisë së përgjithëshme e noterizuar,
- Licenca e punës lëshuar nga –OIK e noterizuar,
- Të jetë banorë i Republikës së Kosovës;
- **Patenten e shoferit drejtim manual kategoria B, së paku dy (2) vite përvojë si vozitës;**
- Dokumenti identifikues kopje si dhe kriteret e përgjithëshme si më poshtë që vlejné për të gjithë zyrtarët publik:

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik (Neni 9 i LZP-së 08/L-197):

1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë:
 - 1.1. të jetë shtetasi i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
 - 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
 - 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;

- 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe
- 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fletëaplikacioni i plotësuar;
- Kopja e Diplomës së Fakultetit të Mjekësisë/Shkollës së mesme të mjekësisë (e noterizuar);
- Kopja e licencës së punës lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë- OMK (e noterizuar);
- Jetëshkrimi (CV);
- Kopja e letëmjoftimit apo e pasaportës;
- Kopjet e dëshmisë së përvojës së punës (e noterizuar)
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike), ndërsa kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Certifikata mjekësore (Pas përzgjedhjes)
- Dëshmia se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (Pas përzgjedhjes);
- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit (Pas përzgjedhjes)

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Testi me shkrim (deri 70 pikë)
- Intervista me gojë (deri 30 pikë)

Procedurat e konkurimit:

Konkurimi është i hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa dallim, të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe dispozitat e Ligjit të Punës, Ligjit për Zyrtarët Publik, dhe të Rregullores (QRK) - nr. 30/ 2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në portalin shtetëror: <https://konkursi.rks-gov.net> si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/>.

Informata të përgjithshme:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në Zyrën për Shërbim me Qytetarë, nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune, në sportelet 10,11,12 në Komunën e Drenasit, aplikacionet mund të shkarkohen edhe nga web-faqja <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen përmes (e-mail) ose në mungesë të një konfirmimi përmes email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale të noterizuara të kualifikimit që i kanë kryer.

Në rast të mos dorëzimit të dokumentacionit origjinal të noterizuar, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.

Konkursi dhe rezultatet do të publikohen në portali shtetëror: <https://konkursi.rks-gov.net> si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/>.

Vërejtje:

Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.

Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.

Deklarimi i rrejshëm paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Gllogoc
Opština Glogovac / Municipality of Gllogoc**



**Zyra e Kryetarit/Kancelarija Gradonačelnika/Mayor's Office
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/ Jedinica za/Single Resource Manager**

